



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE
JASHTË
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. Q-22361 / prot.

Tiranë, më 08/11 / 2021

Lënda: Kthim përgjigje

Z. DORIAN MATLIJA

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. Q-22361, datë 05.10.2021 dhe ka kaluar për shqyrtim te Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. prot. Q-22361/1, datë 05.11.2021 si vijon:

"Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (DKZHT), në përgjigje të kërkesë suaj, me anë të së cilës kërkoni informacion mbi zbardhjen e lejes për rindërtimin e shkollës "Sami Frashëri" dhe vënien në dispozicion të kopjes të vendimit për miratimin e lejes së ndërtimit të saj, ju bëjmë me dije se:

Në Bashkinë Tiranë nëpërmjet sistemit elektronike të lejeve është depozituar kërkesa për "Leje zhvillimi në rastet e fatkeqësisë natyrore", me objekt "Shkolla e mesme e përgjithshme SAMI FRASHERI 1, 2 dhe 4 kate me 1 kat nëntokë", në pasurinë 6/411, zk 8360, në pronë të Bashkisë Tiranë, ndodhur në rrugën e "Barrikadave", me zhvillues "Bashkia Tiranë" dorëzuar elektronikisht me nr. prot. A-1535, datë 21.01.2021, me numër AN200120210083. Pas shqyrtimit administrativ të kërkesës së sipërcituar me anë të Vendimit nr. A-1535/4, datë 16.03.2021 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë është miratuar "Leje zhvillimi në rastet e fatkeqësisë natyrore", për "Shkolla e mesme e përgjithshme SAMI FRASHERI 1, 2 dhe 4 kate me 1 kat nëntokë".

Gjithashtu nga verifikimi i sistemit elektronik të lejeve DKSHT-ja konfirmon se nuk ka kërkesë për leje ndërtimi për rindërtimin e shkollës "Sami Frashëri".

Bashkëlidhur gjeni A-1535/4, datë 16.03.2021 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë".

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT


Blerta Goxha



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

V E N D I M

Nr. Prot. A-1535/4

P Ë R

Miratimin e lejes së zhvillimit për "Leje zhvillimi në rastet e fatkeqësisë natyrore", për "Shkolla e mesme e përgjithshme SAMI FRASHËRI 1, 2 dhe 4 kate me 1 kat nëntokë", në pasurinë me nr. 6/411, vol. 36, fq. 236, zona kadastrale 8360, në rrugën e "Barrikadave", Njësia Administrative nr. 9, Tiranë, me pronar dhe zhvillues Bashkia Tiranë.

Bazuar në bazuar në nenin 8, pika 2; nenin 9, pika 1/1, shkronja "b"; nenin 23, pika 14; nenin 64 shkronja "a", të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore"; Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar); Nenin 24 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 për "Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" (i ndryshuar); Ligji nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile"; Aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"; Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore" (e ndryshuar), vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 158, datë 26.12.2019 për "Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës" (i ndryshuar); Urdhëresës së Kryetarit të Bashkisë nr. 8741, datë 21.03.2016 "Për procedurën e shqyrtimit të aplikimeve të lejes së zhvillimit/ndërtimit, deklarata paraprake për kryerje punimesh, çertifikatë përdorimi, gen plane azhurnimi dhe përditësimet e infrastrukturave të tjera" (e ndryshuar); Urdhër nr. 11987, datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë "Për ngritjen e Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë" (i ndryshuar); Manualin e Procedurave dhe Organizimit të Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendim nr. 11987/1 datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë (i ndryshuar)", si dhe mbështetur në opinionin e datës 26.02.2021 të Këshillit Teknik, lidhur me shqyrtimin e kërkesës për leje zhvillimi dorëzuar elektronikisht me numër aplikimi AN200120210083 dhe protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me nr. prot. A-1535, datë 21.01.2021, për "Leje zhvillimi në rastet e fatkeqësisë natyrore", për "Shkolla e mesme e përgjithshme SAMI FRASHËRI 1, 2 dhe 4 kate me 1 kat nëntokë", në pasurinë me nr. 6/411, vol. 36, fq. 236, zona kadastrale 8360, në rrugën e "Barrikadave", Njësia Administrative nr. 9, Tiranë, me pronar dhe zhvillues Bashkia Tiranë.

V E N D O S A :

1. Miratimin e lejes së zhvillimit për "Leje zhvillimi në rastet e fatkeqësisë natyrore", për "Shkolla e mesme e përgjithshme SAMI FRASHËRI 1, 2 dhe 4 kate me 1 kat nëntokë", në pasurinë me nr. 6/411, vol. 36, fq. 236, zona kadastrale 8360, në rrugën e "Barrikadave", Njësia Administrative nr. 9, Tiranë, me pronar dhe zhvillues Bashkia Tiranë, sipas planit të vendosjes së zonës së zhvillimit bashkëlidhur vendimit.





2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen e këtij vendimi dhe zbardhjen e dokumentacionit përfundimtar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

2021.03.16

18:09:05 +01'00'

ERION VELIAJ


| | | |
|-------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Frida Pashako: | Drejtori Përgj. e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Zhvillimit të Territorit |  Frida Pashako <small>Drejtor Përgj. e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit</small> |
| Enkelejda Murtaj: | Përgjegjëse, Sekretariati Teknik |  Enkelejda Murtaj <small>Përgjegjëse, Sekretariati Teknik</small> |
| Matilda Sotiri: | Specialiste, Sektori i Rindërtimit |  Matilda Sotiri <small>Specialiste, Sektori i Rindërtimit</small> |
| Rozeta Koxhaj: | Jurist, Sektori e Rindërtimit |  Rozeta Koxhaj <small>Jurist, Sektori e Rindërtimit</small> |

PLANI I VENDOSJES SË OBJEKTIT PËR LEJE ZHVILLIMI NË RASTET E FATKEQËSISË NATYRORE PËR OBJEKTIN "SHKOLLA E MESME E PËRGJITHSHME SAMI FRASHËRI 1, 2 DHE 4 KATE ME 1 KAT NËNTOKË"; NDODHUR NË RRUGËN E "BARRIKADAVE"; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 9; NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË ME ZHVILLUES BASHKINË TIRANË

SIPËRFAQJA E TRUALLIT 3314.02 M²

SIPËRFAQJA E TOKËS E ZENË NGA STRUKTURA 1910 M²

SHKALLA 1:500



MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISË TIRANË

ERION VELIAJ

2021.03.16

18:09:25

+01'00'

TREGUESIT E ZHVILLIMIT:
 SIPËRFAQJA E PRONËS QË ZHVILLOHET 3314.02 M²
 SIPËRFAQJA E TOKËS E GJURMËS SË STRUKTURËS 1910 M²
 SIPËRFAQJA E NDËRTIMIT MBI TOKË 6670 M²
 INTENSITETI I NDËRTIMIT 2.01
 KOEFICIENTI I SHFRYTËZIMIT 57.6 %
 LARTËSIA E STRUKTURËS 16.0 M

DISTANCAT NGA KUFIRI I PRONËS:
 VERIU: 8.0 m NGA KUFIRI I PRONËS PËR VOLUMIN 2 KAT
 12.5 m NGA KUFIRI I PRONËS PËR VOLUMIN 4 KAT
 JUGU 2.9 - 5.0 m NGA KUFIRI I PRONËS PËR VOLUMIN 4 KAT
 1.2 m FAQE KALLKAN NGA KUFIRI I PRONËS PËR VOLUMIN 4 KAT
 PERËNDIM 2.6 m NGA KUFIRI I PRONËS PËR VOLUMIN 1 KAT
 1.2 m NGA KUFIRI I PRONËS PËR VOLUMIN 2 KAT
 1.2 - 8.1 m NGA KUFIRI I PRONËS PËR VOLUMIN 4 KAT
 LINDJE 1.3 m NGA KUFIRI I PRONËS PËR VOLUMIN 2 KAT
 10.4 m NGA KUFIRI I PRONËS PËR VOLUMIN 4 KAT

DISTANCAT NGA TRUPI I RRUGËS NË PROJEKT:
 LINDJE: 1.4 m NGA KUFIRI I PRONËS PËR VOLUMIN 2 KAT
 10.4 m NGA KUFIRI I PRONËS PËR VOLUMIN 4 KAT

DISTANCAT NGA OBJEKTET EKZISTUESE:
 VERIU: 8.0 m NGA STRUKTURA EKZISTUESE 1 KAT PËR VOLUMIN 2 KAT
 JUGU: 1.2 m FAQE KALLKAN NGA STRUKTURA EKZISTUESE 2 KAT PËR VOLUMIN 4 KAT
 9.3 m NGA STRUKTURA EKZISTUESE 2 KAT PËR VOLUMIN 4 KAT
 PERËNDIM 7.9 m NGA STRUKTURA EKZISTUESE 9 KAT PËR VOLUMIN 1 KAT
 LINDJE: 19.2 m NGA STRUKTURA EKZISTUESE 4 KAT PËR VOLUMIN 2 KAT


SKEMA E VENDOSJES TRUALLIT TË NDËRTIMIT

shkalla 1:2500



POZICIONI KADASTRAL

shkalla 1:1500



| | | | |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|---------------|------------|
| REPUBLIKA E SHqipërisë BASHKIA E TIRANË DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT | DREJTORI I PËRSHITIS-EM | FRIDA PASHKAO | 16.03.2021 |
| | DREJTORI I CREATORISË SË MONITRIMIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT | | |
| | DREJTORI I CREATORISË SË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT | ANISA MANË | 16.03.2021 |
| | PËRSGJEGËS I SEKTORIT TË PLANIFIKIMIT PËR RINDËRTIM | ELIPIH MEË | 16.03.2021 |
| | PËRSGJEGËS I SEKTORIT TË PËRGATITJES SË APLIKIMEVE PËR LEJE PËR RINDËRTIM | ALBA MEËTOJA | 16.03.2021 |
| | PËRSGJEGËS I SEKTORIT TË PROJEKTIMIT INZHINIERIK | FATMIR KOSHA | 16.03.2021 |
| SPECIALIST I SEKTORIT TË PËRGATITJES SË APLIKIMEVE PËR LEJE PËR RINDËRTIM | OLETA AGASI | 16.03.2021 | |
| SPECIALISTI I SEKTORIT TË INDOPLANIFIKIMIT | ELIJONA ÇELAJ | 16.03.2021 | |
| ARHITEK | ALBANA KOCOLLARI | 16.03.2021 | |